

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA
 GOVERNMENT OF KOSOVO
 MINISTRIA E DREJTËSISË/MINISTARSTVO PRAVDE
 MINISTRY OF JUSTICE
 No.Dr.No: 02-379/3
 Data/Datum/Date: 13/1/2020
 Shtojca/Dodaci/Annex: -3-
 PRISHTINË/A



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada – Government
 Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice
 Departamenti për Profesione të Lira – Departmant Slobodnih Profesija – Department of
 Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Diciplinska Komisija/ The Disiplinary Comitee

Nr.11/2020

KOMSIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUES PRIVAT, në përbërje të Xhemil Elshani kryesues, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha anëtarë, në çështjen disiplinore ndaj Përmbauesit Privat , si organ përmbaues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore i dyshuar për shkelje disiplinore nga neni 367 par.1 nënpar. 1.2, 1.4 dhe 1.7 të LPP-së, dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ MD.nr.09/2014, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike në të cilën prezentuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë për profesionet e lira- Divizioni për Noteri dhe Përmbauesit privat Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore të palës ankuese , me prezencën e përmbauesit privat pas mbajtjes së seancës për këshillim dhe votim të mbajtur me dt. 25.09.2020, muar këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET Raporti përfundimtarë i Ministrisë së Drejtësisë –Departamenti për profesione të lira – Divizioni për Noterin dhe Përmbauesit Privati DPL 11/2020 të dt. 22.05.2020, dhe ankesa e palës ankuese , të dt. 08.05.2020 si e pa bazuar.

II.Organi Përmbaues- Përmbauesi Privat , nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore të pretenduara nga neni 367 par. 1 nën par. 1.2, 1.4 dhe 1.7 të LPP-së, sipas lëndës përmbauese P.nr. 166/19.

A r s y e t i m

Pranë Ministrisë së Drejtësisë të Prishtinës, për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përmbauesit privat , si organ përmbaues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për territorin e Gjykatës Themelore , ër shkeljen disiplinore nga neni 367 par. 1 nën par. 1.2, 1.4 dhe 1.7 të LPP-së, me dt. 22.05.2020 bazuar në ankesën e ankuesit J , të dt. 08.05.2020, ka parashtruar ankesën sepse përmbauesi privat në këtë rast me rastin e ndërmarrjes së veprimeve procedurale përmbauese sipas lëndës P.nr.166/19 të dt. 08.04.2019

ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit të procedurës përbarimore, duke mos ndërmarr veprime të shpejta procedurale përbarimore, duke mos patur transparencë në kryerjen e kësaj detyrë, duke qenë arrogant dhe me sjellje injoruese e fyerëse të përbaruesit privat ndaj kreditorit-ankuesit në këtë rast.

Ministria e Drejtësisë – Departamenti për profesionet e lira – Divizioni për Noteri dhe Përbaruesit Privat me dt. 22.05.2020 ja ka paraqitur komisionit disiplinor propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përbaruesit privat [emri], si organ përbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për territorin e Gjykatës Themelore [emri], i dyshuar për shkelje disiplinore e nga nenet 367 par. 1 nën par. 1.2, 1.4 dhe 1.7 të LPP-së, sepse i njëjti me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përbarimore sipas lëndës së përbarimit P.nr.166/19 të dt. 08.04.2019 ka shkelur ligjin e përbarimit duke mos ndërmarr veprime procedurale të shpejta, duke mos qenë transparent ndaj palës kreditore si dhe duke e injoruar të njëjtin.

Në kuptim të dispozitave të nenit 4 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ MD.nr.09/2014 komisioni disiplinor ka caktuar seancën dëgjimore me dt. 25.09.2020 në ambientet- zyrat e Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën seancë kanë marrë pjesë të gjitha palët në procedurë, si ankuesi- përbaruesi privat [emri] si dhe përf. i Ministrisë së Drejtësisë- Departamenti për profesionet e lira – Divizioni për noteri dhe përbarues privat Fadilete Hoxhaj në cilësinë e iniciuesit të procedurës disiplinore.

Në seancën dëgjimore të mbajtur me 25.09.2020 kryesuesi i komisionit disiplinor në fillim të seancës dëgjimore ja ka dhënë mundësinë shkelësit disiplinor të pretenduar respektivisht përbaruesit privat [emri] që të deklarohet lidhur me përgjegjësinë disiplinore për pranimin e përgjegjësisë në pajtim me nenin 7 par. 3 UA-MD.nr.09/2014 për procedurën disiplinore me çrast përbaruesi privat ka deklaruar se nuk e ndien veten përgjegjës për shkelje disiplinore të pretenduar.

Përf. i autorizuari i Ministrisë së Drejtësisë – Departamenti për profesione të lira- Divizioni për noteri dhe përbarues privat Fadilete Hoxhaj, në fillim të seancës dëgjimore ka bërë shpjegimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj përbaruesit privat [emri], duke theksuar se mbetet pranë pretendimeve të theksuara me shkrim, se përbaruesi privat [emri] ka bërë shkelje disiplinore nga 367 par. 1 nën par. 1.2, të LPP-së, sepse i njëjti me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përbarimore sipas lëndës P.nr. 166/19 të dt. 08.04.2019 dhe veprimet e tija ka bërë shkelje ligjore sepse nuk ka vepruar në kuptim të dispozitave të ligjit për përbarim.

Ankuesi i [emri] gjatë seancës dëgjimore disiplinore ka theksuar se organi përbarues – përbaruesi privat [emri], me veprimet e tija përkitazi me përbarimin e çështjes përbarimore sipas lëndës P.nr. 166/19 të dt. 08.04.2019 ka shkelur ligjin e përbarimit duke mos ndërmarr veprime procedurale të shpejta, duke qenë i një anëshëm, duke mos qenë transparent ndaj palës kreditore si dhe duke bërë injorancë dhe fyerje ndaj të njëjtit.

Përbaruesi privat [emri] gjatë seancës dëgjimore disiplinore të datës së lartpërmendur ka deklaruar se me pranimin e propozimit për iniciimin e procedurës disiplinore brenda afatit ligjor kam dorëzuar deklaratën me shkrim lidhur me lëndën që ka qenë objekt i shqyrtimit- me dt.


2020, duke u thirur në pretendimet e palës ankuese përkitazi me shkeljet disiplinore me çrast
kam vepruar në kundërshtim me ligjin konkretisht në kundërshtim me nenin 16, 341 pika 1.5
1.7 të LPP-së. Deklaroj se pretendimet e palës ankuese nuk
qëndrojnë, unë si përmbarues privat kam vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e LPP-së në afat
ligjor me çrast kam marr aktvendim për lejimin e përmbarimit si dhe kam lëshuar urdhërinë për
përmbarim, kam ndërmarrur veprime tjera ligjore për çka me dt. 24.09.2019, kemi bërë realizimin
e një pjese të borxhit të debitorit në emër dhe llogari të kreditorit në këtë rast ankuesit dhe ate në
shumë prej 1.200 euro, për çka bazuar në rrethanat ekzistuese për shkak të pandemisë në Kosovë
pas këtij afati përmbaruesi privat nuk ka mund të ndërmerr veprime procedurale të kënaqshme siç
kërkon kreditori, por të cilat veprime për një kohë shumë të shkurtër do të ndermirren në të ardhme
dhe do të bëhet përmbarimi i tërësishëm i borxhit të debitorit ndaj kreditorit. Sa i përket
pretendimeve tjera të parashtruara nga ana e kreditorit-ankuesit si në ankesë ashtu edhe gjatë
seancës dëgjimore të mbajtur nuk qëndrojnë se unë veproj në mënyrë të ngadalshme, jam
neglizhent, se jam i një anshëm në këtë çështje dhe nuk veproj me qëllim nga se e njoh palën
debitorë, nuk janë të vërteta, dhe për të gjitha për këto që u përmend më lartë i kam thënë në
përgjigjen time me shkrim.

Komisioni disiplinor pas përfundimit të seancës dëgjimore, të të gjitha palëve në procedurë, si dhe
pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të njëjtave, veç e veç dhe të gjithave së bashku si dhe
provave tjera të parashtruara me qëllim të vërtetimit të drejt dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë
çështje. Ka ardhur në përfundim se gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të këtij vendimi është
vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të saktë dhe se përmbaruesi privat
me rastin e përmbarimit të çështjes përmbaruese të lartpërmendur, nuk ka bërë shkelje disiplinore
me rastin e zbatimit të LPP-së, si dhe as që ka bërë keqe përdorim të detyrës zyrtare lidhur me
çështjen në fjalë- çështjes përmbarimore P.nr. 166/19 të dt. 08.04.2019, nuk është gjetur se ka
kryer shkelje disiplinore në këtë çështje përmbarimore për shkak se gjatë ndërmarrjes së
veprimeve përmbarimore i është përmbajtur dhe i ka zbatuar dispozitat e ligjit të procedurës
përmbarimore.

Andaj më sa u tha më lartë e duke vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 4 par. 1 dhe 2 të
Udhëzimit Administrativ- MD.nr. 09/2014, dhe nenit 374 par. 1 të LPP-së, komisioni disiplinor
vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT
DPL. nr.11/2020 të dt. 25.09.2020

Kryetari i Komisionit Disiplinor
Xhemil Elshani



KËSHILLI JURIDIK : Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konfliktin
administrativ bazuar sipas nenit 374 par. 5 të LPP-së.